

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIE E JUSTIÇIË
DIPLOMË

Nr. Prot: 3063/11
E. Prot: 12
No. Prot: 12

Data: 22 / 11 / 2022

Prishtine, 22



REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF JUSTICE
DIPLOMA

025

2680/2

- 10 -

22 / 11 / 22

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit

Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCË:	615/2680-2-2022
DATË:	22.11.2022
PËR/ZA/TO:	Nazmi Thaqi – zv. Drejtor i Departamentit Ligjor / Ministria e Mbrojtjes
CC:	Avdyllkadër Muçaj – zv. Sekretar i Përgjithshëm – Ministria e Mbrojtjes
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Urim Salihu – Zyrtar i Lartë Ligjor Divizioni i të Drejtës së BE-së Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse “Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland”

I nderuari z. Thaqi,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për “Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland”

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit
Kancelaria Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

22.11.2022

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mbrojtjes me datë 21 nëntor 2021 bazuar në Nenin 7, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafin 3 dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr.02/2021 e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.04/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së në Zyrën e Kryeministrit “*Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland*”.

1. SUBJEKTI

Opinion ligjor për përputhshmërinë e “*Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland*” me *acquis* të BE-së.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Ministrisë së Mbrojtjes për opinion ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti përfundimtar i Projektligjit (*shqip, anglisht, sërbisht*);
- Marrëveshja Implementuese ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (*shqip, anglisht, sërbisht*)
- Deklarata e Përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me *acquis* të BE-së (*shqip, anglisht, sërbisht*) dhe
- Memorandumi shpjegues (*shqip, anglisht, sërbisht*);

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 nënparagrafi 1.3, Nenit 13 paragrafi 6, Neni 21 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, më datë 22 nëntor 2022 lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për opinionin ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në kopje fizike dhe elektronike më datën 21 nëntor 2022 me numër të referencës 2680.

5. HYRJE

Qëllimi i këtij projektligji është të ratifikohet marrveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland.¹ Ky Projektligj ka gjithsej katër (4) nene.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT AKTIT

Në kuadër të BE-së, fusha e sigurisë dhe mbrojtjes në mënyrë të përgjithshme rregullohet në kuadër të Traktatit për Bashkimin European neni 42 dhe 43 që përcakton dispozitat për politikën e përbashkët për sigurimin dhe mbrojtjen. Ndërsa protokoli 11 i Traktatit për Bashkimin European thekson karakterin e *veçantë të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes që kanë Shtete të caktuara Anëtare...*² andaj fushëveprimi i projekt-aktit në fjalë nuk bie ndesh me legjislacionin të BE-së. Rrjedhimisht, kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA MINISTRIA E LINJËS

Në aspektin përmbajtësor dhe ligjor: Duke ju referuar pikës 6 të këtij Opinioni ligjor, dispozitat e “*Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland*” nuk rregullohen në nivel të BE-së dhe si rrjedhojë ky projektligj nuk transpozon ndonjë akt të së drejtës së BE-së.

Në aspektin teknik: Të gjitha dokumentet e tjera janë dërguar dhe plotësuar sipas Manualit për Plotësimin e Tabelave të Përputhshmërisë dhe Deklaratës së Përputhshmërisë.³

¹ Neni 1 i Memorandumit Shpjegues, nëntor 2022

² Neni 42, 43 dhe Protokoli 11 i Traktatit për Bashkimin European; https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lishenes_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf

³ E qasshme në: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzuese-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>

8. OPINIONI PËR PËRPUTHSHMËRINË


Ky opinion për përputhshmërinë me *acquis* është bazuar në përmbajtjen e projektligjit. Përgjegjësia e Divizionit të së Drejtës së BE-së në (ZKM) vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa organi propozues (MM), është përgjegjëse të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) atëherë kur Projektakti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë si dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projektligjit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës.

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Fushëveprimi i “*Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësorisë në ishujt Falkland*” nuk është subjekt që transponon *acquis* të BE-së dhe si e tillë kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Me respekt,

Urim Salihu



Zyrtar i Eartë Ligjor
Divizioni i të Drejtës së BE-së
Zyra Ligjore/ Zyra e Kryeministrit